



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 776/2 Prot.

Tiranë, më 17.11.2021

**V E N D I M**

Nr.142, datë 17.11.2021

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së procesit të vlerësimit periodik Janar - Qershor 2021, të nëpunëses \*\*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektore”, në Drejtorinë e Inspektimit të Punës, në institucionin Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar; nenit 90/2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me disa pretendime për parregullsi në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, për periudhën e vlerësimit Janar - Qershor 2021, të paraqitur nga nëpunësja \*\*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektore”, në Drejtorinë e Inspektimit të Punës, në Inspektoriatin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore,

**Vërej se:**

Nëpunësja civile \*\*\*\*\*\*, nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 776 prot., datë 1.09.2021, ka ngritur disa pretendime për parregullsi të shumta ligjore, të lejuara gjatë realizimit të procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Janar - Qershor 2021.

Pretendimet e ngritura prej saj qëndrojnë kryesisht në **a)** kapërcim të kompetencave të zyrtarëve që kanë detyrimin për vlerësim të nëpunësit (*zyrtari kundërfirmues dhe zyrtari autorizues, janë i njëjti person*) **b)** mungesën e komenteve dhe argumentimit për mënyrën e vlerësimit dhe **c)** mosrespektimin e fazave të procesit të vlerësimit, detyrime këto të përcaktuara në nenin 62, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe në vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, të ndryshuar.

Për verifikimin e pretendimeve të mësipërme, u shqyrtua gjithë dokumentacioni shkresor i dërguar nga institucioni ISHPSHSH nëpërmjet postës elektronike (*emailit zyrtar*), si dhe dokumentacioni bashkëlidhur kërkesës së nëpunëses, prej nga rezultoi se punonjësja \*\*\*\*\* është nëpunëse civile dhe kryen detyrën “*Inspektore*”, në Sektorin e Statistikës, në Drejtorinë e Inspektimit të Punës, në Inspektoriatin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Eprori i saj direkt, në kuadër të procesit të verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave, si dhe aftësive dhe dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, bazuar në nenin 62, të ligjit nr. 152 /2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si për gjithë punonjësit e tjerë, ka kryer edhe vlerësimin e rezultateve në punë për nëpunësen \*\*\*\*\* për periudhën Janar – Qershor 2021. Ky akt i është paraqitur për nënshkrim nëpunëses në datën 27.7.2021.

Me këtë vlerësim nëpunësja në fjalë, nuk ka qenë dakord dhe për këtë ka ushtruar të drejtën e ankimit, nëpërmjet shkresës nr. 1818 prot., datë 10.08.2021, drejtuar titullarit të institucionit, në cilësinë e *Zyrtarit Autorizues*. Nëpërmjet ankesës, nëpunësja ka kërkuar sqarime në lidhje me arsyen e ndryshimit të nivelit të vlerësimit, si dhe rishikimin e tij. Ndërkaq i është drejtuar edhe Komisionerit, për të vlerësuar drejtësinë e pretendimeve të saj dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera.

Nga këqyrja e formularit të vlerësimit, vërehet se ai është i rregullt nga pikëpamja formale, pasi, është nënshkruar nga të gjithë personat përgjegjës, të ngarkuar nga ligji për kryerjen e procedurës së vlerësimit (*zyrtari raportues dhe zyrtari kundërfirmues/ autorizues*).

Referuar Vendimit me Nr. 109, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, në pikën 3, të kreut II të tij, “*Sistemi i Vlerësimit të Rezultateve në punë*”, përcaktohet qartë se: “*Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese kryhet bashkërisht nga zyrtari raportues, zyrtari kundërfirmues dhe zyrtari autorizues*”, duke respektuar fazën e planifikimit, fazën e bisedimeve të ndërmjetme dhe fazën e vlerësimit përfundimtar.

Në kuptim të kreut I, pikës 2, të këtij vendimi:

- b) “Zyrtar raportues”, është nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën e hierarkisë organizative, nëpunësin që do të vlerësohet;
- c) “Zyrtar kundërfirmues”, është nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën hierarkike, zyrtarin raportues;
- ç) “Zyrtar autorizues”, është nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën e hierarkisë, zyrtarin kundërfirmues.

Nisur nga përkufizimet e mësipërme, në përputhje me kushtet konkrete të institucionit, i cili sipas konfirmimit të njësisë së burimeve njerëzore, duke qenë se pozicioni i Drejtorit të Drejtorisë i cili do të paraqitet në rolin e “Zyrtarit Kundërfirmues”, është vakant ( ai është liruar nga detyra në datën 19.03.2021), akti i vlerësimit, me të drejtë është plotësuar dhe nënshkruar me cilësinë “Zyrtar raportues” nga Përgjegjësi i Sektorit dhe si “Zyrtar kundërfirmues/autorizues”, është paraqitur Kryeinspektori (drejtuesi i institucionit), të cilit në këtë rast, i ka kaluar edhe autoriteti i “Zyrtarit kundërfirmues”.

Më tej, duke analizuar përmbajtjen e formularit të vlerësimit të rezultateve të punës, konstatohet se për punonjësen \*\*\*\*\*, është kryer vlerësimi me pikë, për çdo objektivi të përcaktuar për periudhën e vlerësimit (janar-qershor 2021) dhe në përfundim të procesit, punonjësja është vlerësuar nga zyrtari raportues, në nivelin, **1** “Shumë mirë”.

Konstatohet se Zyrtari Kundërfirmues/Autorizues, nuk ka qenë dakord me këtë nivel vlerësimi dhe për këtë arsye, në ndarjen DH, ka bërë vlerësimin e nëpunëses në nivelin **3** “Kënaqshëm”, duke mos dhënë asnjë argument apo arsyetim për këtë vlerësim.

Njëkohësisht, konstatohet që kjo kërkesë ligjore nuk është respektuar as nga zyrtari raportues, konkluzionet dhe vlerësimet me pikë të të cilit janë të paarsyetuara dhe të paargumentuara. Mungesa e komenteve në të gjitha rubrikat, do të thotë se jemi përpara një procesi administrativ me mangësi në raport me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, i cili shoqërohet me konkluzione me karakter subjektiv dhe të pa verifikueshme, si nga ana e zyrtarëve që marrin pjesë në proces pasi nuk mund të vlerësojnë konkluzionet e zyrtarit paraardhës, ashtu edhe nga ana e organeve mbikëqyrëse.

Në raste të tilla, kur konkluzioni i këtyre zyrtarëve është i ndryshëm, bazuar në pikën 4, e kreut III, të VKM nr. 109, datë 26.2.2014, të ndryshuar, duhet të kishte një bashkëbisedim ndërmjet tyre, për të sqaruar mosrakordimin në vlerësim. Konkretisht në këtë dispozitë thuhet:

*“Kur ka mosmarrëveshje midis zyrtarit autorizues dhe/ose zyrtarëve kundërfirmues apo raportues lidhur me nivelin e vlerësimit, kjo çështje diskutohet dhe zgjidhet ndërmjet tyre. Nëse nuk bien dakord, vendimi përfundimtar për vlerësimin e rezultateve në punë, në mënyrë të arsyetuar, merret nga zyrtari autorizues.”*

Po kështu, siç u tha më sipër, me cilësinë e “Zyrtarit kundërfirmues/zyrtar autorizues”, është paraqitur Kryeinspektori, pasi “Zyrtari kundërfirmues” - Drejtori i Drejtorisë, është liruar nga detyra në datën 19.03.2021, pothuaj në mes të periudhës së vlerësimit.

Për këto raste, në bazë të pikës 6, Kreu III, i Vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, të ndryshuar, kur gjatë periudhës së vlerësimit, zyrtarët që duhet të bëjnë vlerësimin largohen nga ai pozicion apo ndodhen në pamundësi të vazhdimit të mëtejshëm të detyrës, ata janë të detyruar të bëjnë vlerësim të pjesëshëm për nëpunësin/nëpunësit, për periudhën gjatë të cilës kanë ushtruar detyrën.

Në këtë rast, konstatohet që “Zyrtari kundërfirmues” – ish Drejtori i Drejtorisë, nuk e ka përmbushur këtë detyrim dhe për nëpunësen \*\*\*\*\*, nuk ka një vlerësim të pjesshëm të kryer prej tij.

Për këto raste, pika 8, e Kreut III, të po këtij vendimi, ka parashikuar se:

*“Në rast se marrja e vlerësimit sipas pikës 6 të këtij kreu, është e pamundur, zyrtari zëvendësues bazohet në vlerësimet e mëparshme.”*

Në zbatim të këtij detyrimi ligjor, zyrtari autorizues, i cili ka marrë edhe atributet e prororit direkt (zyrtarit kundërfirmues), për vlerësimin e nëpunëses në fjalë, duhet të bazohet edhe në vlerësimet e kryera për periudhat e mëparshme, gjë që rezulton të mos jetë kryer.

Në këtë përfundim arrihet nga këqyrja e formularëve të mëparshëm të vlerësimit, përkatësisht atë të periudhës Janar – Qershor 2020 dhe Korrik – Dhjetor 2020, periudhë në të cilën nëpunësja është vlerësuar në nivelin **I** “Shumë mirë”.

Pra, në këtë rast, ndryshimi i vlerësimit nga niveli **I** “shumë mirë”, i kryer për këtë 6 mujor nga zyrtari raportues, në nivelin **3** “Kënaqshëm”, të kryer nga zyrtari kundërfirmues/zyrtari autorizues, si dhe mungesa e komenteve dhe arsytimit se në cilat drejtime dhe për cilat arsye, është kjo rënie e nëpunëses në rezultatet e punës, tregon se procesi i vlerësimit të punës është trajtuar si një akt formal, sipas të cilit diskrecioni i drejtuesit (Zyrtarit Autorizues) është i pakontrollueshëm.

Nga sa parashtruam më sipër dhe nga analiza në tërësi e dokumentacionit dhe e rrethanave të çështjes, arrijmë në konkluzionin se procedura e ndjekur për vlerësimin e rezultateve në punë për nëpunësen \*\*\*\*\*, është kryer në kundërshtim me kërkesat dhe frymën e nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”, i ndryshuar me vendimin nr. 252, datë 30.03.2016, të Këshillit të Ministrave.

Është me vend të theksohet se sistemi i vlerësimit të rezultateve në punë është një proces i rëndësishëm, i cili konsiston në verifikimin e realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuara në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive dhe dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave. Ai i shërben përmirësimit të aftësive profesionale të nëpunësit civil dhe të cilësisë së shërbimit dhe ka pasoja të rëndësishme për nëpunësin civil, pasi shërben për të marrë vendime objektive në lidhje me periudhën e provës, mundësinë e zhvillimit të karrierës nëpërmjet ngritjes në detyrë, lirim nga shërbimi civil, përparimin në hapat e pagës si dhe në përcaktimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim profesional të nëpunësit civil.

Nëse komentet do të ishin shënuar me korrektësi dhe qartë në gjithë aktet e vlerësimit, kushdo që do të njihej me aktet e vlerësimit, do të ishte në gjendje të krijonte një përshtypje të drejtë, në lidhje me shkaqet e mosrealizimeve të detyrave nga ana e nëpunëses dhe në mënyrë bindëse do të arrinte në përfundimin për drejtësinë ose jo, të ndryshimit të vlerësimit nga titullari i institucionit (*Zyrtari Autorizues/Kundërfirmues*).

Nisur nga gjithë sa më sipër, arrihet në konkluzionin se procesi i vlerësimit të nëpunëses \*\*\*\*\*, për periudhën Janar - Qershor 2021, është një proces i paligjshëm pasi nuk janë respektuar rregullat e përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil, për vlerësimin e nëpunësve civilë, prandaj në bazë të nenit 109, pikat “d” dhe “dh” dhe 113/1, të ligjit nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, vetë organi publik (*Zyrtari Autorizues – në këtë rast titullari i institucionit*) duhet të vendosë anulimin e procesit të vlerësimit dhe përsëritjen e tij nga fillimi, duke patur për bazë rregullat për të cilat u fol në pjesën e mësipërme të këtij vendimi.

#### **Për këto arsye:**

Në zbatim të nenit 15 pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, neneve 54 e 55, pikave “d” dhe “dh” të nenit 109 dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*” dhe neneve 16, pika 8 dhe 35, të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë:

#### **VENDOSA:**

1. Të kërkoj nga Kryeinspektori i Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, në cilësinë e *Zyrtarit Autorizues*, të vendosë anulimin e procesit dhe aktit të vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Janar – Qershor 2021, për nëpunësen civile \*\*\*\*\*, si një proces i kundraligjshëm dhe përsëritjen e e tij nga fillimi, në të gjitha hapat e tij.

2. Njësia përgjegjëse të marrë masat dhe të ndjekë procesin për plotësimin e detyrës së mësipërme, duke mbajtur parasysh vërejtjet e përmendura në pjesën arsyetuese të vendimit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, lihet një afat 20 ditë nga komunikimi i vendimit.
4. Ky vendim ti komunikohet, Departamentit të Administratës Publike, Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe nëpunëses \*\*\*\*\*.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**